

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburant Diesel dhe Benzine per nevojs te OSHEE GROUP sh.a”**

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09200000-1 - Naftë, qymyr dhe produkte të naftës.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**-191,959,400 (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind) lekë, pa TVSH.**

**- 1,610,938.23 (nje milion e gjashtëqind e dhjete mije e nenteqind e tridhjetë e tete pike njetzet e tre ) Euro pa tvsh, shenim: referuar kursit te B.SH date 29.06.2022 1 euro =119.16 ALL**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE Group Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:**

Kjo kontrate nuk eshte ndare ne lote pasi administrimi i saj do te behet nga OSHEE Group sh.a, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontrates do te behet nga qendra, ndarja dhe frangmentimi i saj do te krijonte kompleksitet dhe veshtiresi ne zbatim.

Objekti i kontrates lidhet me furnizim me mallra qe tregohen nga operator ekonomik te cilet ofrojne te gjitha kategorite mallrave te kerkuara. Persa me lart ndarja ne lote do ta nderlikonte dhe veshtiresonte procesin e zbatimit te kontrates duke krijuar vonesa dhe shpenzime operative shtese dhe rrjedhimisht do sillte veshtiresi dhe vonesa per menaxhimin e kontrates duke dubluar sere procesesh zinxhir. OSHEE Group sh.a ne baze te marreveshjeve te nenshtruara me kompanite bija ne varesi ka marre persiper te ofroje te gjitha sherbimet lidhur me proceset e prokurimit dhe menaxhimit te kontratave, ndaj ne kete kuader ka krijuar struktura dhe trajnuar personel per mbulimin e ketyre sherbimeve.

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....  
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2. 1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontratës për këtë objekt procedure prokurimi, kërket që OE ofertues të deshmojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetim i xhiros për tre vitet e fundit në një vlerë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të

*thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK krijon siguri dhe besueshmëri që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

---

## **2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listen e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku në Tiranë të jenë minimalisht 3(tre) stacione shitje me pakice pasi ka shtrirje territoriale të madhe dhe përqendrim të shumë Institucioneve, kjo vertetur me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie, kontrate noteriale qeraje/furnizimi, ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj).

**2.4.2** Të gjitha stacionet e tregimit me pakice të karburanteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- 1.Licence leshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakice;
- 2.Leje mjedisore perkatëse leshuar nga QKL;
- 3.Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- 4.Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- 5.Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitje me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave;

**2.4.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vertetim të leshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standardeve të legjislativës Shqiptar.

**2.4.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Vërtetim Teknik të leshuar nga organet e miratuara të vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Leje Mjedisore të tipit B, të leshuar nga QKL, Certifikate e mbrotjes nga zjarri leshuar nga M.Z.SH, dhe Police Sigurimi leshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregimit me shumicë që

verteton kapacitetet depozituese mbi 10 000 m<sup>3</sup> lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

**2.4.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Flete analiza të lëshuar nga ISHTI të cilat duhet të jenë lëshuar brenda 30 diteve nga data e hapjes së ofertave.

**2.4.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin e pandërprere në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritet kontraktor, dhe konkretisht - Tiranë, Durrës, Kavajë, Shijak, Krujë, Lushnjë, Berat, Kucovë, Skrapar, Fier, Vlorë, Ballsh, Gjirokastrë, Sarandë, Tepelene, Permet, Korce, Pogradec, Bilisht, Kolonjë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Shkoder, Koplik (Malesie Madhe), Lezhë, Pukë, Burrel, Kurbin, Bulqizë, Diber, Mirditë, Kukës, Tropojë dhe Has.- me karte elektronike të personalizuar me targonë e cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- OE duhet të paraqesë hartën e vendndodhjeve të distributoreve të tij, (Pikat e karburanteve ku mund të kryhet furnizimi me karte elektronike ose tollona) në pronesi apo me qera APO NË MARREVESHJE ME TË TRETË. Pikat të jenë të shoqëruara me informacionin për përgjegjësinë e pikës së karburantit dhe kontaktin. (OE i cili nuk disponon pika karburanti në të gjitha qytetet ku ushtron aktivitet AK, duhet të paraqesë kontrata qiraje apo kontrata bashkëpunimi/furnizimi të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasitë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targonë e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike dhe tollonat duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme edhe gjatë viteve 2022 dhe 2023.
- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një nderfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo nderfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasitë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit si dhe administrimi i sasitë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.
- Disponimi /Ekzistenca e nderfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mësipër, do të demonstrohen nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

**Mos ofrimi i Nderfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përben kusht për kualifikim.**

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 gërma a) , pikës 6 gërma c), pikës 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, persa i perket ofertës teknike.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.*

**Njësia e Prokurimit:**